



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Nr.faq/Bc.str. 48

Data/Datum. 16.01.2023

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

Datë: 16.01.2023

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 68 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 17, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 280 të datës 29.12.2022, bën këtë:

NJOFTIM PËR PJESËMARRJE NË DISKUTIM PUBLIK

Njoftohen qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës dhe të gjithë të interesuarit e tjerë, se diskutimi publik është i hapur nga data 16.01.2023-29.01.2023 për: "Planin e Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2023".

Për sqarime dhe konsultime tjera, lidhur me 'Planin e Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2023', mund të drejtoheni në ndërtesën e Komunës së Fushë-Kosovës:

- Zyra e Kuvendit të Komunës kati përdhësë;
- Zyra për Informim Publik, kati i parë dhe
- Grupi Punues i Kuvendit.

Takimi për konsultim publik do të mbahet më datën: 19.01.2023, në orën 10:00h dhe 24.01.2023, në orën 10:00h, në sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në ndërtesën e Komunës.

Njoftimi për diskutim publik publikohet në ueb-faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.

Bartës i takimeve publike është Grupi Punues i Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Përsëndetje!



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJO

Nr./No./Rr./Str. 280
Data/Datum 20.12.2022
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 28.12.2022

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 22.12.2022, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 270, të datës 13.12.2022, të paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, i shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafiu 12.2, shkronja (ç), nenin 40, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 9, të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 62, të datës 16.05.2013 mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2023

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2023.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2023.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA



REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 12.12.2022

Për: Kuvendin e Komunës së Fushë-Kosovës,

Prej: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Ali Ismaili

Lënda: Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023

Qëllimi i Planit Vjetor të Punës së Kuvendit është që të:

- Sigurojë që Kuvendi po i përmbush obligimet ligjore duke i miratuar të gjitha Rregulloret që i parasheh ligji me qëllim të shfrytëzimit efektiv të resurseve të komunës;
- Shërbejë si instrument i mbikëqyrjes së punës së administratës përmes dorëzimit të raporteve financiare dhe të performancës;
- Ngris efikasitetin e punës së Kuvendit të Komunës dhe të administratës dhe
- Ngris transparencën e Kuvendit të Komunës.

Plani Vjetor i Punës shërben si një mjet për informimin e qytetarëve për aktivitetet e planifikuara të Kuvendit, të cilët mund të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në vendimet të rëndësishme financiare, ekonomike dhe sociale.

Plani Vjetor i Punës i mundëson çdo anëtar të Kuvendit të fokusohet në veprimtaritë e ardhshme të planifikuara: shpesh nga ata kërkohet që të marrin vendime që nuk janë në kompetenca të tyre profesionale, duke ditur më parë çështjet të cilat do të shqyrtohen në Kuvendin e Komunës, anëtarët e Kuvendit të kenë kohë të kërkojnë pikëpamjet dhe të konsultohen nga ekspertët dhe qytetarët.

Plani Vjetor i Punës së Kuvendit duhet të sigurojë se komuna është duke i ekzekutuar kompetencat në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, ligjet, rregulloret dhe vendimet e tjera të Kuvendit të Komunës.

Synim i punës së Kuvendit të Komunës duhet të jetë avancimi i zhvillimit të komunës që lidhet me dokumentet strategjike të komunës, e të cilat janë:

- Korniza Afatmesme Buxhetore
- Plani dhe programet tjera zhvillimor e sektoriale
- Strategjinë për Zhvillimin Ekonomik Lokal
- Plani Zhvillimor Komunal
- Hartën Zonale të Komunës.

Në bazë të këtyre dokumenteve strategjike duhet të përcaktohen synimet e Kuvendit të Komunës për vitin 2023, që duhet të deklarohen në Planin Vjetor. Duke u mbështetur në Planin e Punës, puna e Kuvendit do të avancojë pozitën e tij udhëheqëse, duke demonstruar qartë çështjet prioritare që do të shqyrtohen gjatë vitit.

Kuvendi i Komunës ka si objektiv të vetin të përmbushë rolin e tij legjislativ dhe mbikëqyrjen si dhe të ngris transparencën dhe llogaridhënien e Kuvendit.

Aktivitetet në të cilat jemi mbështetur gjatë punës për hartimin e Planit Vjetor janë:

- Ligjet themelore të qeverisjes lokale, ligjet sektoriale, dokumentet strategjike të komunës, Statuti i Komunës, Rregulloret Komunale, Plani Vjetor i Punës së Kryetarit (Administratës Komunale) si dhe të dokumenteve tjera të nevojshme.
- Identifikimi i të gjitha veprimeve që duhet të përmbushen gjatë vitit: Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës, Krahësimi i shpenzimeve tremujore me planifikimin e buxhetit, Raporti financiar final, Raporti i Auditimit, Dëgjimet Publike, Korniza Afatmesme Buxhetore, Miratimi i buxhetit, rregulloret që duhet të miratohen, rregulloret që duhet të plotësohen dhe aktivitetet ceremoniale të Kuvendit.

Realizueshmëria - Plani i Veprimit Janar/Dhjetor 2023

Ekzekutivi i Komunës duhet të dorëzoj pikat për shqyrtim në Kuvendin e Komunës, deri me datën dhjetë të muajit përkatës dhe përfundimisht deri në fund të javës së dytë të muajit.

Rekomandimet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete i dorëzohen Kuvendit të Komunës para procesit të vendimarrjes në formën e shkruar.

Janar 2023

1. Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare/deklarime jashtë rendit të ditës; - (60 minuta)
3. Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin përfundimtar të Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023;
5. Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022;

6. Të ndryshme.

Shkurt 2023

1. Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuoromit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare/deklarimet jashtw rendit tw ditws; (40 minuta) - Informimi dhe raportimi me shkrim i Ekzekutivit të Komunës në pyetjet e muajit paraprak - (20 minuta);
3. Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
4. Të ndryshme.

Mars 2023

1. Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuoromit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare/deklarime jashtw rendit tw ditws; (40 minuta) - Informimi dhe raportimi me shkrim i Ekzekutivit të Komunës në pyetjet e muajit paraprak - (20 minuta);
3. Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
4. Raporti përfundimtar Vjetor i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2022;
5. Shqyrtimi i Raportit përfundimtar vjetor financiar për buxhetin e shpenzuar në vitin 2022;
6. Të ndryshme.

Prill 2023

1. Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuoromit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare/deklarime jashtw rendit tw ditws; (40 minuta) - Informimi dhe raportimi me shkrim i Ekzekutivit të Komunës në pyetjet e muajit paraprak - (20 minuta);
3. Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
4. Shqyrtimi dhe krahasimi i shpenzimeve me planifikimin buxhetor për periudhën Janar/Mars 2022;
5. Të ndryshme.

Maj 2023

1. Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorunit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare/deklarime jashtw rendit tw ditws; (40 minuta) - Informimi dhe raportimi me shkrim i Ekzekutivit të Komunës në pyetjet e muajit paraprak - (20 minuta);
3. Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i 'Planit dinamik për organizimin e Dëgjimeve Publike për buxhetin e vitit 2024';
5. Shqyrtimi dhe miratimi i rishikimit të buxhetit për vitin 2022;
6. Informatë e Drejtorisë për Arsim për rrjedhën e vitit shkollor 2022/2023 dhe përgatitjet e nxënësve për testet e semimaturës dhe maturës shtetërore;
7. Të ndryshme.

Qershor 2023

1. Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorunit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare/deklarime jashtw rendit tw ditws; (40 minuta) - Informimi dhe raportimi me shkrim i Ekzekutivit të Komunës në pyetjet e muajit paraprak - (20 minuta);
3. Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026;
5. Të ndryshme.

Korrik 2023

1. Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorunit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare/deklarime jashw rendit tw ditws; (40 minuta) - Informimi dhe raportimi me shkrim i Ekzekutivit të Komunës në pyetjet e muajit paraprak - (20 minuta);
3. Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;

4. Raportimi i Kryetarit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të Komunës për periudhën gjashtëmujore;
5. Shqyrtimi dhe krahasimi i shpenzimeve me planifikimin buxhetor për periudhën Prill/Qershor 2022;
6. Informatë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për zbatimin e planit vjetor të punës në gjashtëmujorin e parë;
7. Informatë e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete për punën në gjashtëmujorin e parë, mbështetur në aspektet ligjore të obligimeve të tij;
8. Raport i Punës së Kryesuesit të Komitetit për Komunitete për gjashtëmujorin e parë;
9. Të ndryshme.

Gusht 2023 - muaji i pushimeve verore të Kuvendit të Komunës

Shtator 2023 - Mbledhja e parë

1. Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare/deklarime jashtw rendit tw ditws; (40 minuta) - Informimi dhe raportimi me shkrim i Ekzekutivit të Komunës në pyetjet e muajit paraprak - (20 minuta);
3. Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
4. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit të ri shkollor 2023/2024;
5. Të ndryshme.

Shtator 2023 - Mbledhja e dytë

1. Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare/deklarime jashtw rendit tw ditws (40 minuta) - Informimi dhe raportimi me shkrim i Ekzekutivit të Komunës në pyetjet e muajit paraprak - (20 minuta);
3. Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të Komunës për vitin 2024;
5. Të ndryshme.

Tetor 2023

1. Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorunit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare/deklarime jashtw rendit tw ditws; (40 minuta) - Informimi dhe raportimi me shkrim i Ekzekutivit të Komunës në pyetjet e muajit paraprak - (20 minuta);
3. Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
4. Shqyrtimi dhe krahasimi i shpenzimeve me planifikimin buxhetor për periudhën Korrik/Shtator 2023;
5. Propozim për formimi i Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;
6. Të ndryshme.

Nëntor 2023

1. Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorunit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare/deklarime jashtw rendit tw ditws; (40 minuta) - Informimi dhe raportimi me shkrim i Ekzekutivit të Komunës në pyetjet e muajit paraprak - (20 minuta);
3. Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
4. Të ndryshme.

Dhjetor 2023

1. Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorunit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare/deklarime jashtw rendit tw ditws; (40 minuta) - Informimi dhe raportimi me shkrim i Ekzekutivit të Komunës në pyetjet e muajit paraprak - (20 minuta);
3. Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;
5. Të ndryshme.

Politikat programore, projekt-rregulloret, propozim-vendimet, planet investive, planet dhe dokumentet strategjike, raportet financiare tremujore dhe vjetore, shqyrtohen paraprakisht në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete.

Plani Vjetor për Auditim të Brendshëm, shqyrtohen në Komitetin për Politikë dhe Financa në mbledhjen e muajit shkurt 2023.

Me respekt!

Grupi Punues

Hasan Gjyrevci

From: aida Jashari <aida_alimi@hotmail.com>
Sent: Monday, January 16, 2023 11:54 AM
To: Hasan Gjyrevci
Cc: Ali Ismaili
Subject: Propozimet e PDK-së

I nderuar

Në takimin e Grupit Punues për 'Planin e Kuvendit për vitin 2023'.

Propozimet e subjektit politik, të Partis Demokratike të Kosoves për planin e vitit 2023 janë këto që kam cekur më poshtë.

I nderuar kryesues, Ali Ismaili kërkojë nga ju që të jenë pjesë e planit vjetorë të punes propozimet tona:

1. Raporitmi i këshillit të siguris, më së paku tri here m'brenda viti.
2. Seanca Solemne për nderë të Panvarsis së Kosoves 17 Shkurtë.
3. Njoftim dhe raport për përfundimit të gjysemvjetorit të parë të vitit 2022-2023.
4. Seanc Solemne për nderë të 8 Marsit.
5. Seanc Solemne për nderë të dites të Çlirimit të Fushë Kosoves 12 Qershori.
6. Raportim në muajin Shtatorë për pregaditjet e vitit të ri shkollorë.
7. Raportim deri ku kanë arritur punimet për plotsim ndryshimin e rregulloreve.
8. Raport deri ku kanë arritur punimet e grupeve të tjera punuse ose komitete.
9. Nëntor rapotrë nga grupi i grave asambleiste për punen e tyre.

Me respekt,
Aida Jashari Alimi.

Get [Outlook for iOS](#)

Datë: 16.01.2023

Për: Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, Ali Ismaili

Nga: Durim Hajra, anëtar i GP për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit Komunal 2023

Lënda: Kërkesë për përfshirje të propozimeve në Planin Vjetor të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2023

I nderuar zotëri Ismaili,

Duke u nisur nga ajo çka është diskutuar në mbledhjet e grupit punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit Komunal, të mbajtura me datë 06.12.2022 dhe 16.01.2023 dhe duke u bazuar në atë që të gjitha propozimet e praqitura në ato takime ishin të pranueshme unanimisht nga të gjithë anëtarët e grupit, por dhe duke parë që të gjitha këto propozime janë të nevojshme dhe ndikojnë pozitivisht në mbarëvajtjen e punëve në Komunën tonë, përmes kësaj shkrese, në emër të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, kërkoj nga Ju, që të përfshini në Planin Vjetor të Punës së Kuvendit për vitin 2023, propozimet e mëposhtme:

1. Muaji janar:

- Informatë e Kryetarit për Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2023;
- Miratimi i Planit vjetor të punës së KKS-së;

2. Muaji shkurt:

- Raporti financiar buxhetor i Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën 1 tetor – 31 dhjetor 2022 (TM 4);
- Raporti financiar buxhetor i Komunës së Fushë-Kosovës, për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2022;
- Informatë për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2022/2023;

3. Muaji mars:

- Raportim/Informatë për punën e Drejtorisë së Inspeksionit;
- Raportim/Informatë rreth raporteve të punës së Drejtorisë së Pronës;
- Seancë solemne për nder të festës 8 Marsi ;
- Raportim/Informatë për punën e Zyrës për Barazi Gjinore;

4. Muaji prill:

- Shqyrtimi i informatës financiare të Komunës së Fushë-Kosovës, për periudhën janar - mars 2023 (TM 1);
- Informatë rrethë raportit për vlerësimin e performancës së Komunës (nga Drejtoria e Administratës);
- Raportim/Informatë e Drejtorisë për Bujqësi rreth mbjelljeve pranverore në komunën e Fushë-Kosovës;
- Informate mbi listen e pronave komunale;

5. Muaji maj:

- Informatë për ndarjen e bursave për studentë;
- Raportim/Informatë nga DKA për gjendjen e sportit në komunën e Fushë-Kosovës;
- Informatë për gjendjen e kulturës në komunën e Fushë-Kosovës;
- Informatë mbi qarkoren e parë buxhetore të brendshme komunale;

6. Muaji qershor:

- Rishikimi i buxhetit për vitin 2023 (nëse ka vendim të qeverisë për rishikim buxhetor);
- Seancë solemne 12 Qershori - Dita e Çlirimit të Fushë-Kosovës;
- Informatë për rendin dhe qetësinë në komunë (Policia e Kosovës);
- Informatë rreth gjendjes së furnizimit me ujë (Kompania e ujësjellësit rajonal "Prishtina", SHA);
- Shqyrtimi i raportit (informatës), rreth aktiviteteve të KKSB-së;
- Informatë mbi realizimin e Planit të Prokurimit.

7. Muaji korrik:

- Raport i punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2023;
- Raporti financiar buxhetor i Komunës së Fushë-Kosovës, për periudhën prill – qershor 2023 (TM2);
- Informatë për raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe plani i zbatueshmërisë për të gjeturat e këtij raporti;
- Informatë mbi qarkoren e dytë buxhetore të brendshme komunale;
- Informatë për performancën e Komunës, MAPL;
- Informatë për realizimin e planit vjetor të Prokurimit Publik, 2023;

8. Muaji gusht: Pushim

9. Muaji shtator:

- Informatë për mbarimin e vitit shkollor 2022/2023 dhe fillimin e vitit të ri shkollor 2023-2024;
- Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të vitit shkollor 2022/2023, testit të arritshmërisë dhe testit të maturës;

10. Muaji tetor:

- Raporti financiar buxhetor i Komunës së Fushë-Kosovës, për periudhën korrik - shtator 2022 (TM3);
- Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi, sasia e sipërfaqeve dhe lloji i kulturave të mbjella përfshirë Informatë nga drejtoria për të mbjellat vjeshtore dhe korrje-shirjet;
- Informatë për gjendjen në institucionet shëndetësore (QKMF, QMU, QMF etj.);

11. Muaji nëntor:

- Informatë për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve për sezonin dimëror;
- Informatë mbi sigurinë në komunën e Fushë-Kosovës (Policia e Kosovës);
- Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në komunën e Fushë-Kosovës;
- Seancë solemne me rastin e festës së 28 Nëntorit;

12. Muaji dhjetor:

- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;
- Informat mbi Planin Vjetor të Prokurimit Publik 2024;
- Informat mbi Planin Vjetor të Auditorit të Brendshëm 2024;
- Informatë për punën e komiteteve;